



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së shtetit. Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e pestë të mbajtur më 16.11.2021 miratoi

Vendim

Procedura e kontrollit të fletës anketuese të _____, ish Kryetari i Gjykatës Themelore _____ NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3771/1 datë 05.08.2019.

Lënda me numër 08 –3771/1 të datës 05.08.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-3771 / 1 e datës 05.08.2019 për kontrollimin e fletës anketuese të _____, ish Kryetarit të Gjykatës Themelore _____ është formuar sipas denoncimin të dërguar në formë elektronike.

Pas mbikëqyrjes së së realizuar në evidencën e saj, KSHPK-ja konstatoi se personi _____, më datë 03.10.2019, ka pasur funksion të ushtruesit të detyrës Kryetar i Gjykatës Themelore _____ dhe nuk ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK brenda afatit të përcaktuar me ligj.

KSHPK në seancën e mbajtur më 21.07.2021 ka miratuar konkluzion kundër të emëruarit për iniciimin e procedurës për kundërvajtje.

KSHPK-ja përgatiti raport për kundërvajtjen dhe urdhërpagesën e konstatuar e dërgoi deri te personi _____. Më datë 26.08.2021 e ka paguar gjobën në

shumën e shënuar në urdhërpagesë për kundërvajtje dhe dëshminë e pagesës e ka dorëzuar në KSHPK të regjistruar me numër 08-2595/3 nga 27.08.2021.

Në pjesën e përcaktimit të gjendjes faktike të të dhënave të cekura në fletën anketuese në rastin konkret, KSHPK-ja ka marrë të dhëna për pronën e _____ dhe familjarëve të tij nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, Ministria e Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike. Depozita qendrore për letra me vlerë dhe nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK pas shqyrtimit të të dhënave të marra nga institucionet e përmendura, si dhe krahasimit të tyre me të dhënat nga fleta anketuese i _____, ish Kryetarit të Gjykatës Themelore _____ konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtutjeshëm në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. NT-M, Këshilltar
Miratoi: NB, anëtar

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska